



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike
Mbledhja nr. 27
Prishtinë, më 19.7.2018, në orën 14:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

P r o c e s v e r b a l

Në mbledhje morën pjesë: Vjosa Osmani-Sadriu, Time Kadrijaj, Danush Ademi, Glauk Konjufca, Fitore Pacolli, Dukagjin Gorani, Elmi Reçica, Evgjani Thaçi-Drangusha, Sergjan Mitroviç dhe Zafir Berisha.

Mungoi: Doruntinë Maloku-Kastrati.

Në këtë mbledhje i pranishëm ishte z. Chris Crewther, kryetar i Nënkomitetit për Politikë të Jashtme të Parlamentit të Australisë, si dhe z. Sabri Kiçmari, ambasador.

Pjesëmarrësit e tjerë: Berita Abazi GP-LVV dhe Jonathan Churchin, praktikant.

Nga zyra e komisionit: Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Vjosa Osmani-Sadriu, kryetare e komisionit.

Rendi i ditës:

Takim i Komisionit me z. Chris Crewther, kryetar i Nënkomitetit për Politikë të Jashtme të Parlamentit të Australisë.

Vjosa Osmani- Sadriu, tha se ky takim është një mundësi e mirë për të parë sesi mund të intensifikohen shkëmbimet në mes të dy parlamenteve dhe se përmes grupeve të miqësisë do të mundohemi që t'i fuqizojmë marrëdhëniet në mes të dy vendeve. Më tej, theksoi se Kosova është falënderuese dhe mirënjohëse për rolin që e ka luajtur Australia para, gjatë dhe pas luftës dhe për mikpritjen që ua ka bërë refugjatëve të Kosovës gjatë luftës. Ajo shtoi se Australia e ka njohur Kosovën menjëherë pas shpalljes së pavarësisë dhe jemi të interesuar që marrëdhëniet në mes të dy vendeve të avancohen më tutje edhe jashtë politikës. Po ashtu, njoftoi se e ka vizituar Australinë, ku është takuar me deputetë të pozitës dhe opozitës.

Chris Crewther, njoftoi se ka punuar në Agjencinë Kosovare të Pronave, në cilësinë e zyrtarit ndërkombëtar ligjor dhe se në vitin 2016 është bërë pjesë e Parlamentit të Australisë. Po ashtu, njoftoi se e ka marrë një ftesë nga Kryeministri i Kosovës, drejtuar ministrit të Jashtëm të Australisë, që ta vizitojë Kosovën. Ai tha se njerëzit nga Kosova janë shumë të kulturuar dhe i kuptojnë vendet, siç është Australia dhe vendet e tjera të botës, se kanë njohuri të mëdha sa i

përket minierave, agrikulturës, turizmit fusha këto ku mund të ketë bashkëpunim në mes të dy vendeve. Z. Crewther shtoi se në Australi, Kosova duhet të bëjë më shumë marketing, në mënyrë që australianët të vijnë dhe ta vizitojnë Kosovën. Ai theksoi se Kosova dhe Australia duhet të punojnë së bashku, në mënyrë që t'i mundësohet Kosovës anëtarësimi në organizata ndërkombëtare, siç është Interpol-i dhe UNESCO. Më tej, njoftoi se Australia është duke e negociuar marrëveshjen për tregti të lirë me BE-në, shpreson se do të bëhet edhe liberalizimi i vizave dhe i tregut në mes të Kosovës dhe BE-së dhe të bëhet edhe një lloj liberalizimi i vizave edhe me Australinë. Z. Crewther bëri të ditur se si kryetari i Nënkomitetit për Politikë të Jashtme do të punojë me kolegët e tij për t'i fuqizuar marrëdhëniet në mes të Kosovës dhe Australisë dhe se duhet të lobohet më shumë për pranimin e Kosovës në Interpol, UNESCO dhe në organizatat tjera ndërkombëtare. Ai shprehu mendimin se Kosova dhe Serbia, në të njëjtën kohë, duhet të bëhen pjesë e BE-së dhe kështu nuk do të ketë më mundësi për konflikte në të ardhmen. Ai, po ashtu, njoftoi se me ndihmën e ambasadorit Kijçmari janë munduar të krijojnë një grup të miqësisë me Kosovën dhe se këtë çështje do ta aktualizojë prapë, posa të kthehet në Australi.

Time Kadrijaj, falënderoi Australinë për ndihmën që ia ka dhënë Kosovës në të gjitha periudhat dhe që ka qenë njëra ndër vendet e para që e ka njohur pavarësinë e saj. Kërkoj që Australia ta shtrijë ndikimin e saj tek ato vende, të cilat nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës. Po ashtu, tha se Bashkimi Evropian e ka dhënë rekomandimin pozitiv për liberalizimin e vizave dhe se kjo çështje duhet të kalojë edhe në disa instanca tjera, ku po ashtu na duhet ndihma e juaj për të lobuar te vendet evropiane. Sa i përket integritit të Kosovës dhe Serbisë në BE, znj. Kadrijaj tha se Kosova ka pasur shumë pengesa në këtë drejtim, sepse gjatë procesit të dialogut është menduar se Serbia ka ecur më përpara, dhe nëse Kosova dhe Serbia duhet të jenë pjesë e BE-së, nuk është e drejtë që Serbia të jetë në BE-së para Kosovës dhe Kosova të mbetet mbrapa, siç ka ndodhur në procesin e liberalizimit të vizave. Ajo bëri të ditur se Kosova është një vend pro evropian dhe perspektivën e Kosovës e shohim në BE dhe në familjen e madhe evropiane.

Chris Crewther, tha se nuk ka dyshim, sa i përket mbështetjes së Australisë, lidhur me anëtarësimin e Kosovës në Interpol, UNESCO dhe në organizata tjera ndërkombëtare. Ai, po ashtu, tha se këtë çështje do ta ngre edhe në komisionin që e udhëheq dhe se do të bisedojë me ministrin e Punëve të Jashtme dhe partitë politike, që t'i inkurajojnë vendet tjera që ta njohin Kosovën dhe t'ia mundësojnë anëtarësimin në organizata ndërkombëtare. Kosova dhe Serbia duhet të bëhen pjesë e BE-së dhe BE-ja duhet t'i udhëzojë të dy vendet për hapat që duhet t'i ndërmarrin dhe rrugën, të cilën duhet ta ndjekin drejt hyrjes në BE. Z. Crewther shoi se Kosova ka institucionet demokratike dhe është më e zhvilluar sesa disa vende që veçse janë pjesë e BE-së. Po ashtu, theksoi se me anë të dialogut duhet të përmirësohen marrëdhëniet me Serbinë. Më tej, tha se anëtarësimi i Kosovës në BE do të sjellë shumë përfitime në fushën e sigurisë, tregtisë, lëvizjes së lirë të mallrave dhe njerëzve, zhvillimit ekonomik, mirëpo do të kenë edhe barrë, për arsye se do të kenë rregulla të reja që do t'i aplikoni.

Elmi Reçica, tha se z. Crewther ka dëshmuar që është mik i Kosovës dhe bëri të ditur se Kosova ka avancuar, prej kohës kur ka përfunduar lufta dhe janë bërë përpjekje maksimale që Kosova të forcohet dhe të integrohet. Hapja e Ambasadës së Kosovës në Australi, tha se është bërë pasi që është vlerësuar kontributi i Australisë për Kosovën dhe që të jemi afër qëndrimeve dhe angazhimeve tuaja për mbështetjen në rrugëtimin e saj. Z. Reçica shtoi se Kosova është shtet i ri, se është duke e kryer shtetndërtimin dhe integrimin e saj, dhe për të përfunduar ky proces, shtetet e vogla kanë nevojë për mbështetjen e shteteve tjera, si Australinë. Ai tha se është e pakuptueshme që të hasim në pengesa për anëtarësim në Interpol dhe UNESCO, sepse shtetet

që i luftojnë fenomenet negative do të duhej të kenë mbështetje. Po ashtu, bëri të ditur se më 22 nëntor 2018 do të votohet anëtarësimi i Kosovës në Interpol dhe se për këtë janë bërë përgatitjet e duhura. Ai, po ashtu, njoftoi se institucionet e Kosovës janë duke u përgatitur për këtë votim, se janë të angazhuara edhe grupet e miqësisë dhe komisionet parlamentare, për të lobuar që Kosova t'i ketë votat e nevojshme për anëtarësim në Interpol. Kërko mbështetjen e Australisë, në këtë drejtim, sepse anëtarësimi i Kosovës është në interes të atyre që janë pozicionuar që në këtë botë të mbretërojë qetësia. Sa i përket UNESCO-s, Reçica tha se është e palogjikshme që të përballemi me pengesa dhe me fushatë kundër anëtarësimit të Kosovës në këtë organizatë. Në këtë drejtim, tha se i kemi vërejtjet tona, sa i përket dialogut, pasi që ekziston një marrëveshje e nënshkruar, se Serbia nuk do ta pengojë Kosovën në anëtarësimin në organizata ndërkombëtare, dhe pavarësisht kësaj marrëveshjeje, ne përballemi me pengesa të shumta. Po ashtu, tha se zhvillimi ekonomik është një çështje specifike dhe ne e dimë nëse nuk jemi të fuqishëm dhe të zhvilluar ekonomikisht, do të kemi telashe të veçanta, por prioritetet e Kosovës për momentin, janë stabiliteti, fqinjësia e mirë me shtetet që na rrethojnë, dhe se e vetmja çështje që është e hapur, me të cilën jemi duke u marrë, janë marrëdhëniet me Serbinë.

Chris Crewther, tha se kur ka qenë në Kosovë në vitin 2012, njohja e pavarësisë në atë kohë ka qenë nën 50%, ndërsa tani është 116, dhe me kalimin e kohës, ka pasur më shumë njohje të pavarësisë. Ai shtoi se pritjet janë shumë të mëdha, mirëpo mund të tejkalohen të gjitha pengesat, me kalimin e kohës, duke e pasur durimin e duhur. Z. Crewther, po ashtu, tha se shpreson që Kosova së shpejti të anëtarësohet në OKB dhe se është optimist se kjo do të ndodhë. Integrimi në BE është prioritet si për Kosovën, ashtu edhe për Serbinë dhe duhet së pari të punohet në këtë pikë, tha z. Crewther. Ai pyeti se a është duke ecur me hapa të sigurt dialogu me Serbinë, nëse ka ngecje apo progres.

Vjosa Osmani- Sadriu, tha se Serbia e ka abuzuar dialogun, për ta minimizuar pozicionin e Kosovës në arenën ndërkombëtare, duke lobuar kundër njohjes së pavarësisë së Kosovës, si dhe njoftoi se ka iniciativa për heqjen e njohjeve të pavarësisë së Kosovës, siç po ndodh me vendet e Afrikës. Më tej, tha se dialogu ka të bëjë me atë që të sigurohemi që të dy vendet t'i normalizojnë marrëdhëniet në mes vete dhe jo të bisedojnë për pavarësinë e Kosovës dhe statusin politik, sepse pavarësia dhe statusi i Kosovës janë procese të pakthyeshme. Ajo njoftoi se Kosova tani po hyn në fazën finale të dialogut dhe është shumë e rëndësishme që të vendosen vijat e kuqe dhe parimet kryesore, në të cilat do të bazohet procesi. Znj. Osmani, tha se komisioni ka një rol të rëndësishëm në këtë proces dhe dy rezoluta që janë miratuar në Kuvend e kanë ngarkuar këtë komision që ta mbikëqyrë dialogun. Bëri të ditur se sipas Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare duhet të miratohen nga Kuvendi me 2/3 e votave, prandaj Kuvendi duhet të jetë i përfshirë në këto procese, përgjatë gjithë kohës dhe jo vetëm në fund sa për votim. Znj. Osmani, në fund, shtoi se qëllimi ynë si shtet është që në fund të procesit të ketë një njohje të dyanshme, dhe në të njëjtën kohë, Kosova të arrijë anëtarësim në OKB. Rreziku më i madh është përdorimi i vetos nga ana e Ruisë, mirëpo gjatë negociatave nuk duhet të propozohen gjëra që do ta minimizonin funksionimin e brendshëm të shtetit tonë. Nuk dëshirojmë që me këtë marrëveshje finale të bëhet një lloj bosnjëzimi i Kosovës.

Chris Crewther, sa i përket ndikimit të Serbisë për tërheqjen e njohjeve, njoftoi se Australia nuk ka shumë ndikim në vendet Afrikane, por ka ndikim të madh në rajonin e Paqësorit.

Vjosa Osmani- Sadriu, shprehu mendimin se është e rëndësishme që këtyre vendeve t'u tërhiqet vërejtja nga Australia, se Serbia do t'iu drejtohet që të jenë kundër Kosovës. Ajo njoftoi se Serbia iu qaset vendeve më të vogla dhe iu japin letra të parapërgatitura, përmes të cilave e

nënvlerësojnë procesin e dialogut, dhe i shtyjnë këto vende që ta nënshkruajnë këtë letër në shkëmbim të parave, armëve e çfarëdo tjetër. Më tej, tha se Serbia iu ka afruar vendeve të vogla në Afrikë dhe vendeve të Amerikës Latine dhe ndoshta të njëjtën gjë mundohen ta bëjnë edhe me vendet që janë pjesë e Paqësorit. Nëse këto vende paralajmërohen përmes Parlamentit të Australisë ose ministrit të Jashtëm, që t'i rezistojnë një iniciative të tillë nga Serbia, ne këtë do ta çmonim shumë, tha znj. Osmani.

Sabri Kiçmari, njoftoi se puna e tij ka qenë që të punojë me Australinë dhe të komunikojë me vendet e Paqësorit për njohjen e pavarësisë së Kosovës. Ai tha se ky proces ka përfunduar para dy vitesh, me njohjen e pavarësisë së Kosovës nga secili vend i rajonit të Paqësorit. Lidhur me mosanëtarësimin e Kosovës në UNESCO në vitin 2015, Kiçmari njoftoi se asnjë nga këto vende nuk ka votuar kundër anëtarësimit të Kosovës në këtë organizatë. Sa i përket Interpol-it, njoftoi se ka kontaktuar me ministrin e Jashtëm të Australisë, Zelandës së Re dhe të vendeve të tjera dhe se është i sigurt që Kosova do ta ketë mbështetjen e shumicës së vendeve anëtare të Interpol-it. Ai, më tej, njoftoi se Serbia është shumë aktive në Guinenë e Re, Ishujt Solomon dhe Fixhi, të cilat kanë kontakte me Rusinë dhe me vendet e tjera, të cilat nuk janë mbështetëse të Kosovës.

Danush Ademi, njoftoi se është përfaqësues i Grupit Parlamentar 6+, i cili përbëhet nga komuniteti turk, boshnjak, rom dhe ashkali. Po ashtu, tha se Kushtetuta e Republikës së Kosovës i njeh të drejtat e komuniteteve, në krahasim me vendet e rajonit dhe se komunitetet në Republikën e Kosovës i gëzojnë të drejtat e barabarta me të gjithë qytetarët e Kosovës dhe janë të privilegjuar në shumë aspekte. Më tej, z. Ademi njoftoi se Kushtetuta e Republikës së Kosovës i garanton 20 deputetë në Kuvendin e Kosovës dhe shprehu dëshirën që komunitetet në vendet e rajonit t'i kenë të drejtat e njëjta, siç i kanë komunitetet në Kosovë.

Vjosa Osmani- Sadriu, sa i përket Guinesë së Re, njoftoi se ka pasur lajme për tërheqjen e njohjes së pavarësisë së Kosovës nga ky vend, për shkak të ndikimit të Serbisë dhe kërkoi nga z. Crewther, që kjo çështje të shikohet me urgjencë. Ajo shtoi se Australia e ka një sistem shumë të avancuar të arsimit dhe do të ishte mirë që studentët kosovarë të gjejnë mënyra për të studiuar në Australi dhe kjo do të ishte një mënyrë e mirë, për të avancuar më shumë marrëdhëniet me Australinë.

Chris Crewther, njoftoi se ka qenë një program i quajtur Kolombo, që ka sjellë studentë në Australi dhe u ka dhënë bursa për studime. Ai tha se do të diskutojë me ministrin e Punëve të Jashtme, se cili është niveli i mundësive për ardhjen e studentëve në Australi dhe e kundërta.

Vjosa Osmani- Sadriu, tha se nëse ka interesim që të ketë praktikantë nga Australia, që të vijjnë në Kuvendin e Kosovës, atëherë dyert i kanë të hapura, në rast se ata kanë interesim të shikojnë modelin e Kosovës.

Mbledhja përfundoi në orën 14:50.

Kryetarja e komisionit,

Vjosa Osmani-Sadriu

E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit.